

SHQYRTIMI PUBLIK PËR PLANET HAPËSINORE DHE URBANISTIKE KOMUNALE

Hyrje

Shqyrtimi publik është vetëm njëri ndër hapat kryesor të hartimit të planeve hapësinore e urbane, në të cilin pjesëmarrësit e ndryshëm kanë mundësinë e fundit për të ofruar komentet e tyre, ngrisin çështjet dhe propozojnë ndryshime. Edhe pse shqyrtimit publik i është dhënë një vëmendje e veçantë në këtë fletushkë, pjesëmarrja publike është rrënjësor në gjithë procesin e përgatitjes së planeve hapësinore dhe urbanistike dhe është reflektuar edhe në Ligjin për Planifikim Hapësinor i aprovuar më 2003. Qasja e re në planifikimin hapësinor dhe urban është në përputhshmëri me parimet e pranuar ndërkombëtare për zhvillim urban dhe qeverisje të mirë dhe vë theks të veçantë në parimet si: transparenca, zhvillimi i qëndrueshëm, pjesëmarrja publike dhe gjithpërfshirja, ofrimi i mundësive të barabarta për të gjithë pa dallim moshe, gjinie, etniteti etj.

Procesi i mirë i planifikimit kërkon përfshirje të vërtetë e direkte të pjesëmarrësve të ndryshëm dhe qytetarëve, që nga fillimi i procesit e deri te zbatimi i tij. Përfshirja e pjesëmarrësve të rëndësishëm në procesin e planifikimit nuk është elementi i vetëm i qeverisjes së mirë, por gjithashtu edhe një mënyrë për të siguruar fonde për projekte dhe investime. Esenciale është zhvillimi i sensit të pronësisë si dhe përgjegjësisë për vendimet si dhe për krijimin e bazës për bashkëpunim, partneritet si dhe zotim të alokimit të resurseve të nevojshme për zbatimin e ideve të pranuar.

Këto janë mënyra të ndryshme për të përfshirë qytetarët dhe pjesëmarrësit në procesin e planifikimit. Shkalla e përfshirjes varet edhe nga fazat e procesit të planifikimit, ekspertiza e kërkuar si dhe mundësia e pjesëmarrësve për të marrë pjesë në proces. Pjesëmarrja publike mund të zbatohet në mënyra dhe forma të ndryshme si përmes konsultimeve publike, debateve për zhvillimin e deklaratave të vizionit, pjesëmarrjen në grupet punuese si dhe në fund por jo më së paku përmes shqyrtimeve publike. Prandaj, shqyrtimet publike janë vetëm një element i zingjirit në procesin e planifikimit. Planifikimi dhe zbatimi mund të jenë të suksesshëm vetëm nëse pjesëmarrja publike është e garantuar gjatë gjithë procesit, filluar nga analiza dhe vlerësimi i situatës, përzgjedha e prioriteteve e deri te zbatimi, monitorimi dhe evaluimi i masave konkrete dhe intervenimet.

Pjesëmarrje e vërtetë

Përfshirja

Pronësia

Përgjegjësia

Partneriteti

Bashkëpunimi

Përkushtimi

Transparenca

Procesi i planifikimit në pjesëmarrje



1. Çka është shqyrtimi publik dhe pse është i rëndësishëm?

☉ Nënkupton takimet publike ku qytetarët ftohen të marrin pjesë dhe të japin komentet, vërejtjet si dhe sygjerimet e tyre në lidhje me planet hapësinore (Plani Zhvillimor Komunal-PZHK) apo planet urbanistike (Plani Zhvillimor Urban-PZHU apo Planet Rregulluese Urbane-PRrU), para se këto plane të dërgohen në Kuvendin Komunal për miratim final.

☉ Ka karakter obligativ përcaktuar sipas Ligjit për Planifikim Hapësinor si dhe udhëzimit administrativ për procedurën e shqyrtimit publik për planet hapësinore dhe urbanistike.

☉ Inkurajon të sigurojë pjesëmarrje transparente publike dhe jodiskriminuese për gjinitë si dhe përfaqësues të shtresave të ndryshme si dhe etniteteve, siguron barazinë gjinore, gjithëpërfshirjen si dhe qasjen jo-diskriminuese në informata, i kontribuon një procesi transparent dhe demokratik të pjesëmarrjes si dhe përfshirjes në përpilimin e planeve si dhe në vendim-marrje.

2. Kush është përgjegjës dhe kush është pjesëmarrës në shqyrtim publik?

☉ Komuna është përgjegjëse për të organizuar shqyrtimin publik për draft-planet hapësinore dhe urbanistike të komunës.

☉ Shqyrtimi publik është i hapur për të gjithë qytetarët.

☉ Qytetarët kanë të drejtë të kenë qasje direkte në draft-planin.


☉ Secili qytetar mund të jap propozime, vërejtje, komente lidhur me përmbajtjen e draft-planit.

☉ Komuna duhet të përpilojë raportin mbi shqyrtimin publik dhe të garantojë transparencë gjatë procesit të shqyrtimit. Raporti ofron përgjigje në vërejtjet e parashtruara duke rishikuar draft-planin ose jep arsyeshmëri për refuzimin e tyre.






Prezantimi Publik i PZHK/PZHU-së
Gjakovë



Shpallje e Shqyrtimit Publik të PZHK-së
Gjilan



Libri i vërejtjeve për PRrU -
Gjakovë



Qasja virtuale e qytetarëve në PZHK/PZHU
Pejë



Peja e miratoi PZHK/PZHU-në

3. Si të informoheni për shqyrtim publik dhe cilët janë hapat e shqyrtimit publik dhe më pas?

- ☉ Komuna shpall shqyrtimin publik të draft-planit hapësinor ose urbanistik.
- ☉ Komuna ndërmerr një fushatë informimi për të inkurajuar pjesëmarrjen e qytetarëve në procesin e shqyrtimit publik.
- ☉ Shpallja e shqyrtimit publik bëhet në më së paku tri gazeta të përditshme dhe në mjete tjera publike të informimit së paku 8 ditë para fillimit të shqyrtimit publik.
- ☉ Njoftimi iu dërgohet Qeverisë, Ministrive, personave juridik me autoritet publik që kanë ofruar të dhëna dhe dokumente tjera të nevojshme gjatë hartimit të draft-planit hapësinor dhe urbanistik, si dhe komunave territori i të cilave mund të ndikohet nga zgjidhjet e propozuara.
- ☉ Komuna vë draft-planin në dispozicion të publikut dhe pjesëmarrësve tjerë për shqyrtim dhe komente.
- ☉ Organi komunal përgjegjës për çështjet urbanistike organizon një apo më shumë prezantime publike me qëllim të shpjegimit të arsyeshmërisë së zgjidhjeve përkatëse.
- ☉ Prezantimi publik i adresohet grupeve të ndryshme në mënyra të ndryshme.
- ☉ Pjesëmarrësit në shqyrtim publik paraqesin sugjerimet, propozimet dhe vërejtjet e tyre.
- ☉ Organet komunale përgjegjëse për çështje të planifikimit shqyrtojnë vërejtjet dhe sygerimet, përmirësojnë dhe plotësojnë përfundimisht verzionin final të draft-planit hapësinor apo urbanistik.
- ☉ Drafti final i dorëzohet Kuvendit të Komunës për aprovim përfundimtar duke përfshirë përmbledhjen e shkurtër të komenteve të bëra gjatë shqyrtimit publik.
- ☉ Plani zhvillimor komunal para aprovimit përfundimtar duhet të merr edhe pëlqimin paraprak nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor për të verifikuar përputhshmërinë e tij me Planin Hapësinor të Kosovës. Ministria ka 15 ditë kohë për verifikim.

4. Sa zgjat shqyrtimi publik?

- ☉ Për draft-planin hapësinor (PZHK) më së paku 60 ditë.
- ☉ Për draft-planet urbanistike (PZHU, PRrU) më së paku 30 ditë.
- ☉ Për propozim ndryshimet, amendamentet apo shfuqizimin e planit më së paku 15 ditë, por jo më shumë se 30 ditë.
- ☉ Rekomandohet që shqyrtimi publik të mos mbahet gjatë sezonit të pushimeve (në verë dhe dimër).

5. Si mund të kontribuoni në shqyrtimin publik?

- Me pjesëmarrje aktive duke i paraqitur sugjerimet, propozimet dhe vërejtjet e juaja në mënyrën dhe afatin e duhur.
- Duke dhënë propozimet dhe vërejtjet tuaja në librin e vërejtjeve.
- Duke shtruar pyetje për çështjet e caktuara gjatë prezantimeve publike.



6. Çka është raporti mbi shqyrtimin publik?

Është një raport i përgatitur nga organi përgjegjës komunal në afatin prej më së shumti 30 ditë, nga dita e përfundimit të afatit për paraqitjen e vërejtjeve. Përfshin regjistrin e pjesëmarrësve që kanë dhënë propozime dhe vërejtje me shkrim për draft-planin si dhe arsyetimin për miratimin, miratimin e pjesërishtëm apo refuzimin e vërejtjeve dhe propozimeve tuaja. Propozimet dhe vërejtjet që kanë arritur pas afatit të dhënë nuk mirren parasysh. Raporti është i hapur për publikun sipas kërkesës.



7. Si përfitoni ju me pjesëmarrjen tuaj në shqyrtim publik?

- Ju bëheni pjesë e procesit të hartimit të planit për komunën/qytetin/lagjen tuaj dhe keni ndjenjën e pronësisë për vendimet e marra gjatë hartimit të planit.
- Ju i kontribuoni procesit të planifikimit në komunën/qytetin/lagjen tuaj përmes ideve, sygjërimeve dhe kritikave tuaja.
- Ju keni mundësinë për të diskutuar ide të ndryshme me profesionistë, zyrtarë të komunës dhe pjesëmarrës tjerë.
- Ju keni mundësi të kuptoni më shumë për rëndësinë e planifikimit hapësinor dhe urban në zhvillimin e komunës/qytetit/lagjes suaj.

Impressum

Kjo fletushkë është iniciativë e MuSPP/UN-HABITAT-it, si vegël komunikimi që ka për qëllim ngritjen e vetëdijes lidhur me pjesëmarrjen e publikut në procesin e planifikimit. Fokusi në këtë fletushkë është në shqyrtimin publik si një komponentë e rëndësishme në zinxhirin e pjesëmarrjes në procesin e planifikimit. Grupi i synuar janë fillimisht organizatat e shoqërisë civile, komuniteti i biznesit, si dhe të gjitha palët me interes në planifikimin hapësinor e urban.

Në këtë fletushkë kontribuon

Teksti: Hidajete Zhuri, Kryesuese e Divizionit të Politikave në kuadër të Departamentit të Planifikimit Hapësinor në MMPH; Lumnije Gashi, Zyrtare për Informim dhe Komunikim në MuSPP dhe Lazim Salihu Këshilltar ligjor në MuSPP. **Redaktorë:** Krystyna Galezia, u.d e udhëheqëses së zyrës së UN-HABITAT-it në Kosovë, Frank D'hondt, Koordinator i Planifikimit Hapësinor në MuSPP. **Dizajni dhe faqesja:** Astron Mahmutaj, Asistent për Informim dhe Komunikim në MuSPP

Kontakt: info@unhabitat-kosovo.org

Programi për Mbështetjen e Komunave në Planifikim Hapësinor në Kosovë i UN-HABITAT-it financuar nga  Sida. Pikëpamjet e shprehura në këtë fletushkë u përkasin autorëve dhe nuk i përkasin UN-HABITAT-it, Sida-s apo Qeverisë Suedeze.